



Ndarja (sortimi) i mbeturinave kursen paratë

Letra, kartoni dhe metali mirren gratis (pa pagesë). Xhamat, konzervat (kanaçet), alumini, bateritë e zbrazëta dhe Tekstili munden të dërgohen dhe deponohen në vendet e caktuara për deponim të komunës dhe mirren gratis. Shishet e plastikës pranohen (deponohen) gratis, aty ku edhe ato shiten. Aparatet elektrike dhe mbeturinat e posaçme (kemikaliet, bateriat) munden të dorëzohen gratis në shitoret ku këto edhe shiten apo munden të deponohen në vendin për grumbullimin e mbeturinave në Militärstrasse. Mbeturinat e amvisërisë, mobiljet dhe mbeturinat e gjelbërta (lulet, bari, pemët etj.) mirren me pagesë.

Thasët e taksuar (paguar)-/ Markat përgjegjëse dhe vendet për shitjen e tyre: Faqja e fundit dyanëshe në «Abfallratgeber» (Udhëzimi për mbeturina)



Mbeturinat të deponohen në kohë të duhur (të caktuar)

Mbeturinat e amvisërisë, mobiljet, mbeturinat e gjelbërta (lulet, bari, pemët etj), Letrat, Kartonat, duhet të deponohen në vendin e shënuar me «K» të gjelbërt deri në orën 7.00 të mëngjezit apo më së herëti në mbrëmjen e fundit para ditës së caktuar për grumbullimin (marrjen) e mbeturinave. Marrja e mbeturinave bëhet një herë në javë. Kur do të bëhet transportimi nga rruga e juaj, mundeni ta shikoni në planin rrugorë të «Abfallratgeber»-it (e Hënë/e Enjëte/e Premte). Mbeturinat e gjelbërta (lulet, bari, pemët etj) mirren çdo të Hënë. Letra dhe kartoni mirren një të Mërkurë në muaj, mvarësisht nga rrethi ku ju banoni (Rrethi 1 / Rrethi 2).

Plani i rrugëve dhe ditët e transportit: Faqja e parë dyanëshe në «Abfallratgeber»



Mbeturinat të deponohen të ndara (të sortuara) në vendin e caktuar

Për mbeturinat e amvisërisë përdorni thasët zyrtarë të ashtuquajtur AVAG-Säcke. Thasët duhet të deponohen në pikën e afërt të shënuar me «K» apo në kontejnerët e caktuar në vendin e banimit tuaj. Mbeturinat e rënda (mobiljet), të shënuara me markën përgjegjëse, mirren poashtu në të njëjtën kohë. Edhe mbeturinat e gjelbërta (lulet, bari, pemët etj) deponohen në vendin e njëjtë, të shënuara me markën përgjegjëse, si dhe të lidhura e të vendosura në korita të hapta (speciale) apo në kontejnere të gjelbërt. Letra dhe kartoni të deponohen të ndara si dhe të lidhën. Në grumbullin e letrës futën vetëm: Gazetat, Revistat si dhe Librat pa kopertina, e jo mbeturina të tjera. Në grumbullin e kartonit futën vetëm: material kartoni të paluar, pa pjesë të plastifikuara (mos të futën kartonat e qumshtit apo të pijeve tjera).


Për grumbullimin e metalit të deponohen vetëm pjesë nga metali. Pjesët nga druri dhe plastika duhet të hiqen (largohen) më para nga metali.



Mbeturinat speciale kthehen prap në shitoret ku shiten

Mbeturinat speciale (kemikaliet, bateriat, poçat (llampat) elektrike, helmet etj) nuk guxojnë të futen në thasët e mbeturinave, por ato munden të deponohen gratis në shitoret përkatëse apo në vendin për grumbullimin e mbeturinave në Militärstrasse. Medikamentet mund të dorëzohen në Apoteka.

Bonin për deponim gratis të mbeturinave speciale der në 20kg: Faqja dyanëshe në mes të «Abfallratgeber»



Mo - Sa 07 - 20 h



Vendet e deponimit të shfrytëzohen gjatë ditës

Për deponimin e xhamave, konzervave, aluminit, baterive dhe tekstilit në rajonin e qytetit kemi në disponim vendet e caktuara publike për grumbullim. Këto vende mund të shfrytëzohen prej të Hënës e deri të Shtundën prej Orës 7.00-20.00. Nuk guxon të shfrytëzohen të Dielen dhe ditëve festë. Deponimi i mbeturinave pranë kontejnerit është i ndaluar.

Mbeturinat nuk bën të futen në kanalizim

Mbeturinat nuk bën të futën në Toalet, Lavamane apo në kanalizime ujore të tjera. Kjo mund të shkaktonë bllokimin e kanalit si dhe ndotjen e ujërave.

Përdorimi i korpave publike për mbeturina

Korpat publike të mbeturinave shërbejnë për hudhjen e mbeturinave që krijohen gjatë rrugës. Është e ndaluar që mbeturinat e krijuara në shtëpi të hudhen në këto korpa publike.

Ndezja e mbeturinave është ilegale

Ndezja e mbeturinave jashtë apo nëpër furra dhe kamina çonë deri te krijimi i tymit helmues, dhe për këtë arsye është e ndaluar. Në vende të hapura është e lejuar vetëm ndezja e materialit natyrorë nga kopshtet dhe malet, nëse gjatë ndezjes krijohet vetëm një sasi e vogël e tymit dhe nëse askush nuk pengohet. Në furrën e drurit lejohet vetëm ndezja e drurit të terur apo Pellets-ave (product në formë cilindrike, që shërbenë për ndezje)

Vendi për grumbullimin e mbeturinave – Shërbim për amvisëri private

Në vendin për grumbullimin e mbeturinave në Militärstrasse, mundën të deponohen mbeturinat nga amvisëria në sasira të vogla. Mbeturinat e ndara (të sortuara) vlerësohen sambas detyrimin pagesorë, dhe pranohen pasi të bëhet pagesa e menjëherëshme. Letra, kartoni, metali dhe mbeturinat speciale deri në 20 kg munden të dorëzohen gratis.

Orari i punës dhe plani ku gjindet vendi: Faqja dyanëshe «Sammelhof / Service im Abfallratgeber»

Informatat e tjera i merrni në:

Tiefbauamt der Stadt Thun
Abfallbeseitigung
Industriestrasse 2
3602 Thun

Tel. 033 225 83 59 / 033 225 84 08
Internet: www.thun.ch/abfallratgeber
www.thun.ch/integration
Email: abfallberatung@thun.ch
Email: kompostberatung@thun.ch

